

STATUTI

I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, që ka si themelues dhe Krye të saj Zotin dhe Perëndinë tonë Jisu Krisht, është institucion hyjnor si prania dhe shfaqja në vend e Një Kise të Shenjtë, Katholike dhe Apostolike, e bashkuar në mënyrë të pandashme me Patriarkanën Ekumenike, me të gjitha Kishat simotra Autoqefale dhe ruan të patundshme burimet e besimit, d.m.th. Shkrimin e Shenjtë dhe Traditën e Shenjtë si dhe Kanonet e Shenjta apostolike e sinodike.
2. Titulli i saj zyrtar është «Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë».

Neni 2

Anëtarë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë janë të gjithë të pagëzuarit në Kishën Orthodhokse dhe janë banorë të Shqipërisë, pa dallim origjine.

Neni 3

1. Kanonet e Shenjta të Kishës Orthodhokse, të cilat përbëjnë themelin e përbashkët të organizimit dhe administrimit të të gjitha Kishave Orthodhokse të botës, rregullojnë sistemin e organizimit, administrimit dhe zhvillimit të jetës së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
2. Në rast se lindin paqartësi në lidhje me interpretimin e saktë të neneve të këtij Statuti, kriter dhe tekst referimi përbëjnë Kanonet e Shenjta.

Neni 4

Rëndësi themelore për Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë kanë:

1. Për sa i përket aspektit kishtar: Tomosi Patriarkal dhe Sinodik, me të cilin Patriarkana Ekumenike, sipas rendit kishtar, i dha asaj autoqefalinë (prill 1937) dhe në këtë mënyrë njohjen kanonike prej të gjitha Kishave Orthodhokse në mbarë botën si Kishë Autoqefale.
2. Për sa i përket aspektit shtetëror: neni 10, paragrafi 6 dhe neni 24 paragrafi 1, 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, me të cilin në bazë të nenit 10, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, si njëra prej komuniteteve fetare tradicionale të vendit, njihet si person juridik dhe është e pavarur në administrimin e pasurisë së saj sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të veta. Me anë të nenit 24, paragrafi 1, 2 garantohet liria fetare dhe e drejta e shprehjes së besimit fetar individualisht ose në grup, në jetën private ose publike me anë të adhurimit, të arsimit, të ruajtjes së zakoneve, dhe të manifestimeve publike.

Neni 5

Marrëdhëniet ndërmjet Shtetit dhe Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë rregullohen sipas neneve 10 dhe 24 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe në bazë të marrëveshjes të parashikuar midis tyre.

Neni 6

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë si vazhduese kanonike e traditës shumëshekullore të Kishës Orthodhokse në territorin gjeografik të shtetit të sotëm shqiptar është e vetmja trashëgimtare e ligjshme e të gjithë titujve, pronave dhe pasurive, të të drejtave të famullive, manastireve dhe bashkësive brenda Shqipërisë.

Neni 7

1. Gjuha zyrtare e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë është shqipja. Orthodoksët e gjuhëve të tjera mund të përdorin gjatë adhurimit hyjnor gjuhën e tyre tradicionale adhuruese, me kusht që tekstet në përdorim të kenë miratimin e Sinodit të Shenjtë, siç edhe për tekstet e shërbesave fetare në shqip.
2. Në korrespondencën me Kisha të tjera Autoqefale apo me subjekte të huaja në përgjithësi, përdoren edhe gjuhë të tjera.

ORGANIZIMI**Neni 8**

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë është e organizuar si më poshtë:

- 1) Kryepiskopata e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, që përfshin Zëvendësitë Kryepiskopale Lokale të Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës dhe Shqipërisë së Veriut.
- 2) Mitropolia e Beratit, që përfshin Zëvendësitë Mitropolitane Lokale të Beratit, Vlorës, Fierit, Lushnjës dhe Mallakastrës.
- 3) Mitropolia e Gjirokastrës, që përfshin Zëvendësitë Mitropolitane Lokale të Gjirokastrës, Pogonit, Përmetit, Sarandës, Delvinës dhe Himarës.
- 4) Mitropolia e Korçës, që përfshin Zëvendësitë Mitropolitane Lokale të Korçës, Prespës, Pogradecit, Devollit dhe Kolonjës.

Neni 9

Kur për arsye baritore (pimantike) gjykohet e nevojshme, Sinodi i Shenjtë mund të formojë mitropoli apo episkopata, duke ndjekur procedurën e parashikuar prej rregullit Kanonik dhe Traditës së Kishës.

Neni 10

Asnjë klerik orthodhoks nuk mund të ushtrojë detyrën e tij priftërore në Shqipëri, në qoftë se nuk është i lidhur kanonikisht me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe pa pasur paraprakisht një leje të veçantë prej autoritetit kishtar kompetent.

SINODI I SHENJTË**Neni 11**

1. Sinodi i Shenjtë është Autoriteti më i Lartë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, sipas Tomosit Patriarkal dhe Sinodik të dhënies së Autoqefalisë prej Patriarkanës Ekumenike. Ai përbëhet nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë si Kryetar i përhershëm dhe nga Mitropolitët e Episkopët aktivë.
2. Sinodi i Shenjtë e ka qendrën në kryeqytetin e vendit dhe titulli i tij zyrtar është: «Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë».

Neni 12

Kompetencat e Sinodit të Shenjtë janë:

- a) Ruan besimin, adhurimin, disiplinën kishtare dhe administrimin (drejtimin) e Kishës sipas dogmave dhe Kanoneve të Shenjta.
- b) Zgjedh Krepiskopin, Mitropolitët dhe Episkopët dhe lëshon Qarkoret përkatëse për njohjen e tyre.
- c) Emëron mëkëmbësit e Mitropolive të Shenjta vakante.
- d) Ushtron kontroll kanonik mbi aktet dhe veprimet e Mitropolitëve dhe Episkopëve, si dhe mbi të gjitha organet e Kishës.
- e) Kujdeset për marrjen e Miros së Shenjtë prej Kishës së Madhe të Krishtit.
- f) Kujdeset për formimin e duhur të Klerikëve dhe Murgjve dhe për zbatimin me korrektësi të detyrave të tyre.
- g) Kujdeset për formimin fetar të popullit orthodhoks nëpërmjet predikimeve, bisedave, katekizmit, vizitave baritore, botimit të literaturës fetare, medias etj.
- h) Miraton literaturën me përmbajtje fetare, e cila mund të qarkullojë brenda famullive, manastireve apo institucioneve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
- i) Vendos për dorëheqjen e anëtarëve të tij.
- j) Gjykon Kryetarin e Sinodit dhe anëtarët e tij për shkelje dogmatike dhe kanonike, në përputhje me Kanonet e Shenjta. Gjykon çështjet që kanë të bëjnë me zhveshjen e klerikëve.
- k) Interpreton në mënyrë autentike, për të gjitha organet kishtare, dispozitat e Statutit dhe të Rregullores së Përgjithshme të Administrimit.
- l) Thërret Asamble dhe Mbledhje Kishtare kur e lypin nevojat e Kishës.
- m) Ngre Komisione Sinodike për qëllime studimore e konsultative në lidhje me probleme të posaçme.
- n) Mbikëqyr administrimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme të Kryepiskopatës, të Mitropolive, të Famullive dhe Manastireve.
- o) Themelon fondacione dhe shoqata në shërbim të veprës shpirtërore, shoqërore, arsimore e kulturore të Kishës.
- p) Vendos për çështje të çdo natyre, të cilat nuk rregullohen nëpërmjet këtij Statuti apo të Rregullores.

Neni 13

1. Sinodi i Shenjtë mbledhet nën kryesinë e Kryepiskopit rregullisht çdo tre muaj dhe në raste të jashtëzakonshme kur e lyp nevoja.
2. Kompetent për mbledhjen e Sinodit të Shenjtë dhe për caktimin e rendit të ditës është sipas Kanoneve të Shenjta vetëm Kryetari i Sinodit të Shenjtë. Gjithashtu Sinodi i Shenjtë mbledhet nga Kryetari i tij nëse kjo gjë kërkohet me shkrim të paktën prej gjysmës së numrit të anëtarëve të tij.
3. Në mungesë të Kryetarit të Sinodit të Shenjtë kryeson mbledhjen Mitropoliti më i vjetër sipas kohës së dorëzimit, duke pasur urdhrin kanonik me shkrim ose lejen e Kryepiskopit.
4. Pjesëmarrja e kryepriftërinjve në mbledhjet e zakonshme ose të jashtëzakonshme të Sinodit të Shenjtë është e detyrueshme. Ata që mungojnë pa ndonjë arsye serioze në këto mbledhje iu nënshtrohen sanksioneve të parashikuara prej Kanoneve të Shenjta.

Neni 14

Sinodi i Shenjtë ka Kryesekretar klerik dhe Sekretar klerik të propozuar nga Kryepiskopi dhe të emëruar nga Sinodi i Shenjtë.

Neni 15

Sinodi i Shenjtë konsiderohet i mbledhur rregullisht kur marrin pjesë Kryetari i tij dhe të paktën gjysma e numrit të të gjithë anëtarëve të tij. Merr vendime të vlefshme me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe në rast barazie votash mbizotëron vota e Kryetarit.

Neni 16

Në intervalin kohor midis seancave të Sinodit të Shenjtë, për çështje urgjente ose të zakonshme, është Kryepiskopi ai që vepron dhe informon Sinodin e Shenjtë në mbledhjen e parë të tij ku dhe miraton edhe veprimet e Kryepiskopit gjatë këtij intervali.

KRYEPRIFTËRINJTË**Neni 17**

1. Zgjedhja e kryepiftërinjve bëhet nga Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë sipas Kanoneve të Shenjta.
2. Këshilli Kleriko-laik, propozon kandidatët për dorëzimin në gradën episkopale. Në fund Sinodi i Shenjtë zgjedh njërin prej tyre.
3. Kandidatët për dorëzim në gradën episkopale, përveç cilësive që kërkojnë Kanonet e Kishës, duhet të jenë diplomuar në Akademinë Teologjike "Ngjallja" ose në një fakultet teologjik orthodhoks të nivelit universitar dhe të kenë punuar dhe qëndruar të paktën për një periudhë trevjeçare në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
4. Kryepiftërinjtë e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë kanë shtetësi shqiptare. Në raste të veçanta mund të bëhet përjashtim me vendim të Këshillit Kishtar Kleriko-laik dhe të Sinodit të Shenjtë.
5. Për hirotonisjen e Kryepiftërinjve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë kërkohet të jenë të pranishëm të paktën tre Kryepiftërinj. Në rast se numri i Episkopëve është më i vogël se tre, atëherë mund të kërkohet ndihma e Patriarkanës Ekumenike, e cila ka dhënë edhe autoqefalinë.

Neni 18

Sipas nevojave të Kishës është e mundur të zgjidhen nga Sinodi i Shenjtë Episkopë titullarë aktivë me detyra të caktuara. Këta quhen kryepiftërinj në shërbim aktiv dhe marrin pjesë në Sinodin e Shenjtë.

Neni 19

Gjatë marrjes së detyrës Kryepiftërinjtë japin këtë premtim përpara Sinodit:

«Premtoj përpara Perëndisë Triadik se do të ruaj besimin ndaj dogmave kishtarë dhe kanoneve të Kishës Orthodhokse dhe do të ruaj lidhjet me Patriarkanat Orthodhokse dhe Kishat Autoqefale në mbarë botën».

KRYEPISKOP I**Neni 20**

Kryepiskopi është Kryetari i Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, kreu i të krishterëve orthodhoksë në Shqipëri, përfaqësuesi i tyre përpara autoriteteve shtetërore dhe organizmave ndërkombëtarë dhe përpara çdo lloj autoriteti dhe pushteti.

Neni 21

Titulli i Tij është: «Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë». Kurse fama e tij në shërbesat kishtarë thirret sipas traditës liturgjike të Kishës vendore. Kryepiskopi ka të gjitha detyrimet dhe të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kanonet e Shenjta dhe nga ky Statut.

Neni 22

Kryepiskopi ka këto detyra dhe të drejta:

- a) Ia bën të ditur Kishës së Madhe të Krishtit dhe të gjitha Kishave Orthodhokse Autoqefale motra në të gjithë botën, sipas rregullit të Kishës Orthodhokse, zgjedhjen dhe ngjitjen e tij në fronin Kryepiskopal nëpërmjet letrave fronëzuese. Bën pohimin e ligjshëm dhe siguron se do ruajë në mënyrë të palëkundur besimin orthodhoks dhe çdo gjë që urdhërojnë Kanonet e shenjta, Tradita e Shenjtë dhe rregulli i Kishës së Shenjtë Orthodhokse. Përkujton sipas rregullit në Diptikët emrin e Patriarkut Ekumenik, të Patriarkëve të tjerë dhe të kryetarëve të Kishave të Shenjta Orthodhokse Autoqefale.
- b) Thërret Sinodin e Shenjtë dhe të gjitha strukturat apo organet e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe kryeson mbledhjet e tyre.
- c) Përfaqëson Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë përpara autoriteteve shtetërore dhe kudo që e lyp nevoja, personalisht ose me anë të përfaqësuesve.
- d) Përfaqëson Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në çdo marrëveshje shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme në Shqipëri dhe jashtë vendit, personalisht ose me përfaqësues të prokuruar prej Tij.
- e) Ruan kungimin dhe komunikimin kishtar me Kishat e tjera Orthodhokse.
- f) Nxjerr qarkore për të gjitha famullitë orthodhokse të Shqipërisë, viziton, kur e shikon të arsyeshme, Hierarkët e Kishës.
- g) Dorëzon Mitropolitët dhe Episkopët sipas Kanoneve të Shenjta së bashku me Hierarkë të tjerë, anëtarë të Sinodit të Shenjtë.
- h) Pranon ankesat e justifikuara kundër Kryepriфтërinjve dhe i propozon Sinodit të Shenjtë kryerjen e hetimeve, duke caktuar për këtë qëllim një anëtar të tij.
- i) Viziton të paktën një herë në dy vjet enoritë e Kryepiskopatës dhe i parashtron Sinodit të Shenjtë çdo vit një raport në lidhje me ato.
- j) Kur bëhet fjalë për çështje apo paqartësi të një natyre të përgjithshme kishtarë që i kapërcen kufijtë e juridiksionit përkatës të Kishave Autoqefale, Kryepiskopi i drejtohet sipas rregullit kanonik Fronit Ekumenik, nëpërmjet të cilit realizohet kungimi me çdo episkopatë orthodhokse që përcakton drejt fjalën e së vërtetës dhe kështu u kërkon Kishave motra mendimin dhe pikëpamjet e tyre të vlefshme.
- k) Ndërmerr iniciativa në shkallë të gjerë kur vendi ndodhet në gjendje të jashtëzakonshme për shkak të fatkeqësive natyrore apo për shkaqe të tjera, duke bashkëpunuar me autoritetet shtetërore, me kryesitë e bashkësive të tjera fetare dhe organizmat ndërkombëtarë për lehtësimin e të prekurve dhe zhdukjen e pasojave.
- l) Ushtron edhe çdo të drejtë tjetër që i jepet nga Kanonet e Shenjta.

Neni 23

Kryepiskopi mund të ketë dy deri në tre Episkopë ndihmës, të cilët kryejnë detyra të posaçme të ngarkuara prej tij dhe kanë të gjitha privilegjet e Kryepriфтërinjve aktivë.

MITROPOLITI**Neni 24**

Të drejtat dhe detyrat e Mitropolitit janë si më poshtë:—

- a) Merr pjesë në Sinodin e Shenjtë. Drejton dhe bariton Mitropolinë brenda kufijve të caktuar të dioqezës së tij.
- b) Është anëtar i Sinodit të Shenjtë dhe përfaqëson Mitropolinë e tij përpara autoriteteve shtetërore lokale dhe kudo që është e nevojshme, personalisht ose me anë të përfaqësuesve të tij.
- c) Dorëzon klerikët e dioqezës së tij.
- d) U jep klerikëve të Mitropolisë së tij dënimet e parashikuara nga Kanonet e Shenjta. Për shkelje më të rënda, të cilat përbëjnë skandal, i çon në Gjykatat Kishtare kompetente.
- e) Viziton të paktën një herë në dy vjet famullitë e Mitropolisë së tij, për të kontrolluar ecurinë e punëve kishtare, jep udhëzimet përkatëse dhe i parashtron Sinodit të Shenjtë raportin vjetor përkatës.

Neni 25

Mitropoliti kujton gjatë celebrimit të Liturgjisë Hyjnore «Për Kryepiskopin tonë ...». Gëzon çdo të drejtë që i jepet nga Kanonet e Shenjta.

Neni 26

1. Çdo Kryepriift duhet të qëndrojë vazhdimisht brenda kufijve të Mitropolisë së tij, me përjashtim të rasteve kur merr pjesë në mbledhjet e Sinodit të Shenjtë apo në mbledhje të tjera zyrtare ose kur është me leje të zakonshme. Për çdo rast tjetër kërkohet miratimi i Kryetarit të Sinodit të Shenjtë.
2. Për çështje me karakter zyrtar Kryepriifti komunikon me autoritetet kishtare të Kishave të tjera Orthodhokse Autoqefale nëpërmjet Sinodit të Shenjtë.

ASAMBLEJA KLERIKO-LAIKE**Neni 27**

1. Për trajtimin e problemeve të përgjithshme, të cilat shqetësojnë Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Asambleja Kleriko-laikë mbledhet detyrimisht çdo dy vjet, por edhe në raste të jashtëzakonshme kur e lyp nevoja.
2. Asambleja Kleriko-laikë studion problemet kishtare dhe shoqërore aktuale dhe i propozon Sinodit të Shenjtë dhe Këshillit Kishtar Kleriko-laik masa për kryerjen e veprës kishtare dhe të «dëshmisë» orthodhokse në përgjithësi në botën e sotme. Çështjet dogmatike dhe kanonike janë kompetencë ekskluzive e Sinodit të Shenjtë.

Neni 28

1. Në të marrin pjesë anëtarët e Sinodit të Shenjtë, anëtarët e Këshillit Kleriko-laik, dy përfaqësues nga çdo manastir i shenjtë dhe njëzet klerikë dhe njëzet e katër laikë, me përfaqësim të përshtatshëm, burra, gra dhe të rinj, nga Kryepiskopata dhe Mitropolitë. Sipas kushteve konkrete ky numër mund të shtohet me 1/3 me vendim të Sinodit të Shenjtë.
2. Për Asamblenë e caktuar klerikët zgjidhen prej plenumit të klerikëve të Kryepiskopatës dhe të Mitropolive, ndërsa laikët zgjidhen prej anëtarëve të Këshillave të Famullive dhe prej bordeve të

Fondacioneve të Kishës të miratuara nga Sinodi i Shenjtë. Për të arritur një përfaqësim sa më të mirë të të gjitha dioqezave, Sinodi i Shenjtë lëshon në çdo rast qarkoren përkatëse.

KËSHILLI KISHTAR KLERIKO-LAIK

Neni 29

1. Për administrimin e pasurisë kishtare dhe kontrollin e pasurive të kishave të komuniteteve orthodhokse si dhe të manastireve, Sinodi i Shenjtë krijon në selinë qendrore të Kishës së Shqipërisë «Këshillin Kishtar Kleriko-laik», të përbërë nga të gjithë anëtarët e Sinodit dhe nga dymbëdhjetë klerikë e laikë.
2. Këshilli Kishtar Kleriko-laik merr pjesë edhe në veprimtaritë kishtare të parashikuara në nenet 17, 27, 70 të këtij Statuti.
3. Katër anëtarët klerikë dhe katër laikë të Këshillit Kishtar Kleriko-laik zgjidhen çdo katër vjet prej anëtarëve të këshillave të Kryepiskopatës dhe të Mitropolive. Katër të tjerët zgjidhen nga Sinodi i Shenjtë.
4. Një Komision Ekzekutiv prej pesë anëtarësh, i zgjedhur nga Këshilli Kishtar Kleriko-laik, zbaton vendimet e tij. Të dyja këto struktura kryesohen nga Kryepiskopi.

Neni 30

Përveç Këshillit Kishtar Kleriko-laik funksionon Komisioni i Kontrollit, i cili kontrollon administrimin financiar të Kryepiskopatës dhe të Mitropolive dhe raporton në lidhje me këto në Sinodin e Shenjtë.

Neni 31

1. Këshilli Kishtar Kleriko-laik shqyrton buxhetin e shpenzimeve të vitit të kaluar dhe buxhetin preventiv të ardhshëm, që miratohen përfundimisht nga Sinodi i Shenjtë.
2. Harton Rregulloren e Përgjithshme të Administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, e cila miratohet përfundimisht nga Sinodi i Shenjtë.

Neni 32

1. Këshilli Kishtar Kleriko-laik mbledhet rregullisht dy herë në vit dhe Komisioni Ekzekutiv në çdo tre muaj. Të dy organizmat mbledhen dhe në raste të jashtëzakonshme sa herë që është nevoja me ftesë të Kryepiskopit.
2. Detyrën e Sekretarit të Këshillit Kishtar Kleriko-laik e kryen Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë.

KËSHILLI KRYEPISKOPAL DHE MITROPOLITAN

Neni 33

1. Pranë Kryepiskopatës dhe çdo Mitropolie krijohet një Këshill Kishtar i Kryepiskopatës ose i Mitropolisë në mbështetje të veprës së Hierarkut përkatës.
2. Këshilli Kishtar përbëhet nga Kryepiskopi ose Mitropoliti si Kryetar, nga pesë klerikë dhe pesë laikë me përfaqësim të përshtatshëm, burra, gra dhe të rinj. Anëtarët zgjidhen në çdo katër vjet sipas Rregullore së Përgjithshme të Administrimit.
3. Këshilli Kishtar i Kryepiskopatës ose Mitropolive mbledhet me ftesë të Kryetarit rregullisht tri herë në vit dhe në raste të jashtëzakonshme sa herë që e lyp nevoja. Shqyrton kushtet e krijuara, të cilat ndikojnë në ecurinë e Kryepiskopatës apo të Mitropolive dhe kërkon mënyra më efikase për kryerjen e veprës shpirtërore, baritore dhe shoqërore të Kishës.

ZËVENDËSIA LOKALE

Neni 34

Zëvendësia Lokale është një njësi-kishtare administrative, e cila përfshin një numër të caktuar famullish të një zone të caktuar të Kryepiskopatës apo të Mitropolive.

Neni 35

Kryepiskopi dhe Mitropolitët emërojnë si përfaqësues të tyre një klerik si Epitrop Arkhieratik për çdo Zëvendësi Lokale, i cili koordinon punën kishtare në këtë zëvendësi në emër dhe me udhëzimet e drejtpërdrejta të Hierarkut përkatës.

Neni 36

Epitropi Arkhieratik kryeson Këshillin Kishtar të Zëvendësisë Lokale, i cili përbëhet nga tre klerikë të tjerë dhe tre laikë. Këta zgjidhen për një periudhë katërvjeçare nga Këshillat Famullitare dhe emërohen prej Hierarkut përkatës. Epitropi Arkhieratik kujdeset për zbatimin e porosive, vendimeve dhe urdhëresave të autoriteteve kishtare më të larta në të gjitha famullitë e zëvendësisë.

MANASTIRET

Neni 37

1. Manastiri i Shenjtë është qendër asketizmi, jete adhuruese dhe rrezatimi shpirtëror sipas traditave murgërore të Kishës Orthodhokse.
2. Çdo manastir drejtohet prej Vëllazërisë që jeton në të, nën kryesinë e Igumenit dhe të anëtarëve të Këshillit Igumenik.
3. Manastiret e Shenjta në Kishën e Shqipërisë zbatojnë Kanonet e Shenjta dhe traditat murgërore orthodhokse dhe janë nën juridiksionin e Sinodit të Shenjtë, deri në një vendim të ri Sinodik në lidhje me këtë çështje.

FAMULLIA DHE FAMULLITARËT

Neni 38

Famullia është bashkësia adhuruese eukaristike e besimtarëve, klerikë dhe laikë, të cilët banojnë në një territor të caktuar, qytet ose fshat dhe ka si qendër Kishën e shenjtë.

Neni 39

1. Famullitarët përzgjidhen, dorëzohen dhe emërohen prej Hierarkut përkatës.
2. Çdo famulli ka një ose më shumë famullitarë, sipas numrit të besimtarëve, kishave dhe parakliseve të famullisë dhe sipas të ardhurave të saj.

Neni 40

Famullitari është Kryetar i Këshillit Famullitar dhe përgjigjet për zbatimin e dispozitave të këtij Statuti. Atje ku shërbejnë më shumë priftërinj, kryetarin e cakton Hierarku përkatës.

Neni 41

Priftërinjtë zbatojnë detyrat e tyre, gëzojnë të drejtat e parashikuara prej Kanoneve të Shenjta dhe Traditës së Kishës, me bindje ndaj Kryepriiftit përkatës.

Neni 42

1. Famullia administrohet nga Këshilli Famullitar i cili përbëhet nga:

a) Prifti Famullitari si Kryetar, b) klerikë të tjerë, c) katër deri në dhjetë anëtarë laikë (burra, gra dhe të rinj) sipas madhësisë së famullisë, të cilët emërohen në çdo katër vjet pas propozimit të një numri të dyfishtë kandidatësh nga kryetari i enorisë.

2. Çdo anëtar i Këshillit Famullitar duhet:

a) Të jetë anëtar aktiv i Kishës Orthodhokse (d.m.th. të jetë i pagëzuar, të shkojë në kishë dhe të marrë pjesë në Misteret e Shenjta të Kishës). b) Të mos ketë lidhje farefisnore ose krushqie me Famullitarin apo me ndonjë anëtar tjetër të Këshillit Famullitar. c) Të mos ketë pushtet politik ekzekutiv.

3. Një Këshilltar Kishtar, i cili mungon në mënyrë të pajustificueshme në tri mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Famullitar, zëvendësohet me një anëtar tjetër me propozim të Famullitarit – Kryetar.

4. Këshilltari Kishtar pezullohet:

a) Kur vërtetohet se nuk zbaton vendimet dhe urdhrat e autoritetit epror. b) Kur nuk pranon kontroll financiar nga shërbimi ekonomik kompetent i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. c) Kur vepron si i pavarur dhe kryen vepra pa pasur më parë miratimin e autoritetit të tij epror. d) Kur përdor ambientet e Kishës për qëllime të huaja për të, ose kur ia dorëzon arkën e Kishës një autoriteti jokishtar.

5. Këshilltari Kishtar, i cili është pezulluar me vendim të Hierarkut përkatës, zëvendësohet nga një anëtar tjetër plotësues.

6. Askush nuk njihet si anëtar i Këshillit Famullitar në qoftë se nuk ka shkresë emërimi me nënshkrimin e Hierarkut përkatës dhe vulën e Kryepiskopatës apo të Mitropolisë.

7. Çdo përzjerje nga ana e anëtarëve të pushtetit shtetëror në Këshillat Famullitare bie në kundërshtim me Kushtetutën e Shtetit dhe, për pasojë, Këshilltarë të caktuar nga cilido autoritet shtetëror nuk njihen prej Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

8. Detyra e Këshilltarit Kishtar është pa pagesë dhe e papajtueshme me veprën e nëpunësit me pagesë të Kishës.

9. Kohëzgjatja e shërbimit të Këshilltarëve Kishtarë është katërvjeçare, duke filluar prej 1 shtatorit të vitit të emërimit të tyre deri më 31 gusht të vitit të katërt të emërimit të tyre.

Neni 43

Të drejtën e zgjedhjes dhe të votës në të gjitha Këshillat Kishtarë e kanë të gjithë orthodhoksët, burra dhe gra mbi 18 vjeç, banorë të Republikës së Shqipërisë. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillave Kishtarë të qyteteve dhe fshatrave, si dhe kompetencat dhe detyrat e tyre caktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Administrimit.

PËRGATITJA E KLERIT, SIGURIMI, LEJET**Neni 44**

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë disponon Shkolla të mesme dhe të larta kishtarë për përgatitjen e kuadrove të saj.

Neni 45

Klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dorëzohen burra të panjollë, të cilët përmbushin kushtet e parashikuara prej Kanoneve të Shenjta, kanë të paktën arsimin e mesëm dhe kanë diplomë të Akademisë Teologjike Orthodhokse "Ngjallja" ose të ndonjë Fakulteti tjetër Teologjik që të jetë të paktën i këtij niveli. Vetëm Sinodi i Shenjtë mund të bëjë përjashtime për plotësimin e nevojave të jashtëzakonshme.

Neni 46

Të gjithë klerikët e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe nëpu-nësit e saj sigurohen sipas ligjeve të Shtetit shqiptar.

Neni 47

Një klerik ose një murg i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, për të dalë jashtë kufijve të Shqipërisë duhet të ketë leje me shkrim prej eprorit të tij kishtar.

M B L E D H J E T H I E R A T I K E**Neni 48**

1. Të gjithë klerikët e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë mbledhen rregullisht një herë në dy vjet, ose në raste të jashtëzakonshme kur e lyp nevoja në Mbledhjen e Përgjithshme Hieratike. Qëllimi i saj është trajtimi i problemeve aktuale, ripërtëritja e jetës shpirtërore të klerikëve dhe inkurajimi për kryerjen sa më mirë të misionit të tyre.

2. Mbledhjet hieratike në Kryepiskopatë dhe në çdo Mitropoli bëhen çdo tre muaj ose sa herë që e gjykon këtë Hierarku përkatës.

3. Prania e klerikëve në Mbledhjet Hieratike është e detyrueshme, ndërsa në rast mungese pa arsye vendosen sanksionet e caktuara.

V E P R A B A R I T O R E D H E S H O Q Ë R O R E**Neni 49**

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë tregon kujdes të veçantë për edukimin e krishterë të Rinisë Orthodhokse si dhe për katekizmin e fëmijëve dhe adoleshentëve. Për këtë qëllim krijohet në Kryepiskopatë dhe nëpër Mitropoli një strukturë e veçantë katekistësh e përbërë nga të rinj me përgatitje të posaçme, të diplomuar në Akademisë Teologjike Orthodhokse «Ngjallja» ose dhe nga të rinj që kanë formimin e duhur. Në të gjitha nivelet e jetës kishtarë të Famullive, Kryepiskopatës apo Mitropolive duhet të synohet pjesëmarrja aktive dhe e përgjegjshme e rinisë.

Neni 50

Nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë botohen gazeta, revista, libra dhe broshura për plotësimin e nevojave liturgjike, baritore, shpirtërore e formuese të grigjës Orthodhokse si edhe për nevoja të tjera. Nuk lejohet të qarkullojë literaturë në ambientet e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë pa miratimin e autoritetit kishtar kompetent.

Neni 51

Njëkohësisht me veprën e saj shenjtëruese, predikuese, katekiste e shpirtërore, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë interesohet për përparimin në përgjithësi të shoqërisë

